



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1671 / Prot.
2

Tiranë, më 05.07.2021

VENDIM

Nr. 48, datë 05.07.2021

PËR MIRATIMIN E PAGESËS SË PUNONJËSVE QË KANË MARRË PJESË NË PROCESIN E RREGJISTRIMIT TË STUDENTËVE PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021 NË FAKULTETIN E MJEKËSISË, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË TIRANË

Mëshetur në pika 3/c, pika 4/ç, të nenit 3, pika 1 e nenit 108 të ligjit nr.80, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, VKM nr.463, datë 16.06.2011, "Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.511, datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore", udhëzimit të Ministrit të Financave nr.16, datë 20.07.2011 "Mbi zbatimin e vendimit nr.463, datë 16.06.2011..." shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 10517/1prot, datë 21.06.2021 "Mbi pagesën e mbikohës së punës", si dhe në shkresën nr.1284/5 prot, datë 23.06.2021 "Mbi miratimin e pagesës së sekretarive mësimore, në FSHMT dhe FMD" të Administratores së UMT-së, Bordi Administrimit në mbledhjen e 05.07.2021

VENDOSI:

1. Të miratojë pagesën e mbipunës së kryer nga sekretaritetë mësimore dhe punonjësit e angazhuar në këtë proces në Fakultetin e Mjekësisë, të kryer gjatë procesit të regjistrimit të studentëve për vitin akademik 2020-2021.
2. Vlera e pagesës për të dy fakultetet është si më poshtë:
Fakulteti i Mjekësisë vlera **234,505 lekë, për 532, orë/punë të kryera**,
3. Fondet e nevojshme në vlerën 234,505 lekë (*dyqind e e tridhjetë e katërmijë e pesëqind e pesë*), të përballohen nga fondet e parashikuara në llogarinë 600, duke mos tejkaluar tavanin buxhetor të përlllogaritur në buxhetin e viti 2021.
4. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe Administratorja e Fakultetit të Mjekësisë për marrjen e masave për të kryer pagesat për punonjësit e përfshirë në këtë proces.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Florian TOTI

